

Drejtuar:

- **Prokuroria Themelore Publike – Strugë**
- **Prokuroria Themelore Publike – Shkup**

KALLËZIM PENAL

Nga: Qytetarë të Strugës – të besimit islam, të punësuar në kuadër të BFI-së, anëtarë të Myftinisë.

Kundër:

Bashkesia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, Njësia organizative Myftinia e BFI-së në RMV – Strugë. Përfaqësues i autorizuar: Adi Murtishi nga fshati Ladorishtë.

Për veprën penale:

- Keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe mosrrespektim të Kushtetutës së BFI-së dhe Kushtetutës së RMV-së,
- Bazuar në nenin 8, 26, 27, 28, dhe 37 të Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame,
- Përçarje / Konflikt mes anëtarëve të Myftinisë dhe personelit të BFI-së.

Neni 8

BFI veprimtarinë e vet e mbështetë në parimet e:

- drejtësisë
- transparencës,
- debateve para sjelljes së vendimeve në organet kolektive,
- konsultave në kryerjen e punëve,
- zgjedhjeve, emërtimeve, përgjegjësi dhe shkarkimeve të funksionarëve.

Neni 26

Organet dhe institucionet e BFI-së mund të mbajnë seancë, vetëm nëse në to marrin pjesë shumica e antarësisë nga numri i përgjithshëm.

Neni 27

Thirrja e përfaqësuesit të Rijasetit nëpër seancat e organeve, shoqatave dhe institucioneve të BFI-së është e obliguar.

Neni 28

Organi i Muftinisë numron prej pesë deri në pesmbëdhjetë anëtarë, varësisht nga numri i organeve ndihmëse të saj, pra xhemateve në teritorin përkatës.

Numrin e anëtarëve të Muftinisë, për çdo muftini e cakton Rijaseti.
Të propozuarit në mënyrë proporcionale, duhet të mbulojnë teritorin e Muftinisë.
Mandati i anëtarëve të zgjedhur zgjatë katër vjet.

Neni 37

Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame:
- verifikon mandatet dhe shpall zgjedhjet e rregullta dhe të parakohshme.

Sipas nenit 37 të Kushtetutës së BFI-së:

Zgjedhjet për anëtar të muftinis I shpall Rijaseti I Bashkësisë Fetare Islame

Shkelja e nenit 37 të Kushtetutës së BFI-së nga Adi Murtishi, i cili ka zgjedhur Shpendi Ibrahimin antar të myftinis pa I shpallur Rijaseti zgjedhjet është anti-kushtetut dhe vendim i njëanshëm.

Ne Muftininë e Strugës nuk është diskutuar për kërkes deri te rijaseti për shpallje të zgjedhjeve të parakohshme për antar të muftinis.

Kërkesa jonë drejtuar organeve kompetente është që të ndërmerren masat e duhura për mosrespektimin e Kushtetutës së RMV-së dhe Kushtetutës së BFI-së, përkatësisht nenit 8, 26, 27, 28 dhe 37 të Kushtetutës së BFI-së.

Ne kërkojmë nga Adi Murtishi dhe Myftinia e Strugës përgjegjësi para organeve kompetente të BFI-së dhe institucioneve të drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe sqarim në çfar baze e ka zgjedhur Shpendi Ibrahimin antar të muftinis.

Ne, xhemati, kërkojmë që personat e autorizuar të BFI-së si funksionarë fetarë të jenë shembull për respektimin e Kushtetutës së BFI-së dhe RMV-së, dhe që Myftinia e Strugës të jetë një institucion i drejtë, pa ndikime nga faktorë të jashtëm.

Kjo mënyrë e funksionimit ka krijuar hapësirë për konflikte dhe përçarje midis imamëve, duke dëmtuar unitetin e tyre dhe të këshillave të xhematit në Strugë.

Për mosrespektimin e Kushtetutës së RMV-së dhe Kushtetutës së BFI-së, përkatësisht për shkeljet e lartpërmendura, do të informohen edhe: Prokuroria Publike e Shkupit, Komisioni për Procedurë Disiplinore, Faktori Ndërkombëtar, Parlamenti i RMV-së, Ministria e Drejtësisë së RMV-së, Ambasada e SHBA-së, Misioni i OSBE-së, Bashkimi Evropian, dhe organet kompetente për keqpërdorimin e funksionit.

Strugë, 06.01.2025